

Бр. / Nr. 02-7558/3

29-11-2024 20 год. / viti
POLITIKA E CILËSISË

Шифра од стандардот: п 5.71

Издание:04

Датум на примена:20.11.2024

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut është institucion i specializuar për mbrojtjen sociale, mbrojtjen e fëmijëve, sigurimin social, sigurimin pensional dhe invalidor, mbrojtjen e invalidëve ushtarak demografinë dhe rininë. Në punën e saj dallohen parimet: profesionalizmi, cilësia, pavarësia dhe korrektësia.

MISIONI:

Krijimi dhe zbatimi i politikave efektive dhe të qëndrueshme për sigurimin social për çdo qytetar, për rritjen dhe zhvillimin demografik, për mbrojtjen e fëmijëve dhe familjes dhe për mbështetjen e të rinjve, për sigurimin pensional dhe invalidor, për mundësi të barabarta dhe për mbrojtjen dhe parandalimin e diskriminimit, në përputhje me standarde me standardet dhe parimet evropiane dhe ndërkombëtare.

VIZIONI:

Sistem proaktiv dhe gjithëpërfshirës për sigurim social dhe një politikë demografike efektive, duke ofruar dhe përmirësuar mbështetjen institucionale për fëmijët dhe familjen, të rinjtë e përfshirë dhe aktivë në proceset sociale, një sistem të qëndrueshëm pensionesh dhe një pension të sigurt për çdo person, një gamë të gjerë mundësish të barabarta për qytetarët dhe një shoqëri pa diskriminim, nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe parimeve evropiane dhe ndërkombëtare në kuadrin legjislativ dhe institucional kombëtar.

Qëllimet kryesore të Ministrisë janë:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe përbushja e plotë me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO 9001:2015
- Rritja e kënaqësisë së shfrytëzuesve me cilësinë tonë
- Paanshmëria, praktika e mirë profesionale, efikasiteti dhe etika
- Bashkëpunimi me furnizuesit bazuar në partneritet, besim të ndërsjellë dhe parime të ndërlidhura në veprim.
- Me avancim të vazhdueshëm në funksionim, për të qenë lider në shoqëri
- Kualifikimi adekuat profesional i punonjësve, njohja e detajuar e specifikave të funksionimit dhe edukimi i vazhdueshëm.
- Kryerja e punës me kompetencë dhe përgjegjësi. Të gjitha aktivitetet kryhen në përputhje me kërkesat e dakorduara rregulloret ligjore.
- Përgjegjësia individuale dhe kolektive si bazë për punë.
- Udhëheqësia e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut është plotësish përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Cilësisë.

Shkup, 20.11.2024

